

V E N D I M
Nr.35, datë 10.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datën 9.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.43 Akti që i përket :

K Ë R K U E S E : PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE, e përfaqësuar nga Z. Elmaz Sherifi.

PALE E INTERESUAR : KOMISIONI QENDROR I PERHERSHEM I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga Z. Pëllumb Çela.

O B J E K T I :

Ankim kundër vendimit datë 3.10.1996 të Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve për miratimin e “Rregullores për pjesëmarrjen në zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal të vëzhguesve të huaj e të brendshëm”.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë si subjekt elektoral në zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal, ka kërkuar shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 2 dhe paragrafit të tretë të nenit 10 të Rregullores datë 3.10.1996 të miratuar me vendim të Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve “Për pjesëmarrjen në zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal të vëzhguesve të huaj e të brendshëm”, në të cilat vihen kushtet që vëzhguesit e huaj të kenë eksperiencë vëzhgimi dhe moshë 22 vjeç e lart, ndërsa vëzhguesit e brendshëm të kenë eksperiencën në të paktën një zgjedhje dhe moshë 25 vjeç e lart.

Vendimin për nxjerrjen e rregullores së sipërpërmendur, Komisioni Qendror i Përhershëm i Zgjedhjeve e ka marrë duke u mbështetur në nenin 30, shkronja “d” të Ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, sipas të cilit ky komision “vendos rregulla për pjesëmarrjen në zgjedhjet e vëzhguesve të brendshëm dhe të huaj...”.

Në bazë të nenit 40 të ligjit të mësipërm, kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Kasacionit.

Si rrjedhojë, pala kërkuese ankimin e saj mund ta paraqesë në Gjykatën e Kasacionit.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 40 të Ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, si dhe në bazë të nenit 26 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Mungesën e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall, më datë 10.10.1996

